



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A.nr. 312/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit dhe dëmtimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar.

Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3000 (tremijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik PDK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, sepse subjekti politik PDK, i ka mbuluar posterat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja, duke i vendosur posterat e kandidatës për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Xhevahire Izmaku.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2010, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, në të cilën theksohet subjekti politik PDK i ka mbuluar posterat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja, duke i vendosur posterat e kandidatës për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Xhevahire Izmaku, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterat e kandidatës për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Xhevahire Izmaku nga radhët e subjektit politik PDK, është vendosur mbi posterat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

### **Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK, më datë 04.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar.

### **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posterat e kandidatës për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Xhevahire Iznaku nga radhët e subjektit politik PDK, janë vendosur mbi posterat subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja. Prandaj nga kjo arsye dhe me qëllim të evitimit të shkeljes së lartë cekur e në pajtim më dispozitat e lart

cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 312/2010 më datën 06.12.2010

  
**Kryesuesi i Panelit**  
**Ymer Hoxha**